



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA


AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY

2-D/DPK

02

01-1187/13

19-04-2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë 17.04.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-442/13 për ztr. *Uran Ismaili – Ish Këshilltar Politik në Kabinetin e Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural të Kosovës, për shkak se ai tashmë nuk e ushtron këtë funksion dhe rrjedhimisht nuk ka situatë të konfliktit të interesit.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-442-13, për Zyrтарin e lartë, ztr. Uran Ismaili – Këshilltar Politik në Kabinetin e Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës (MBPZHR), dhe njëkohësisht njëri nga personat e autorizuar të tri bizneseve private “Tranquille”sh.p.k. , “BonVivant” sh.p.k., dhe “BON-VIVANT” sh.p.k. është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastet me numër protokoli; AKK-03-440/13, AKK-03-441-13, dhe AKK-03-442/13 të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtarit të lartë, ztr. Ismaili i është dërguar njoftimi me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ztr. Ismaili, ka qenë në takim me zyrtarët e Agjencisë, duke sjellë edhe një shkresë njoftuese (04/02-336/12) të datës 08.10.2012, në të cilën ka njoftuar se, tashmë, ai është një ish zyrtar i lartë, sepse që nga data 27.09.2012 ka dhënë dorëheqje nga pozita i tij që është aprovuar nga Ministri i MBPZHR-së, në shkresën me numër reference KM 536/12, dhe rrjedhimisht që nga atëherë nuk është as në listën e zyrtarëve të lartë.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, kemi konstatuar se nuk ka situatë të konfliktit të interesit, pasi që ztr. Ismaili, tashmë, nuk ushtron funksionin si zyrtar publik në Qeverinë e Kosovës.

Prandaj në bazë të provave zyrtare të ofruara e të trajtuara lidhur me këtë rast, kemi konstatuar se nuk ka pasur konflikt interesi gjatë ushtrimit të funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

